



RAPORT

Përdorimi i Qeseve të Plastikës në Kosovë

2024

Prishtinë, 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



Agjencia Për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Agencija Za Zastitu Sredine Kosovo
Kosovo Environmental Protection Agency

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Projekti: Circular Urban Development - Kosovo4Green

Përgaditur:

Besnik Krasniqi, konsulent - GIZ
Tafë Veselaj, AMMK/MMPHI
Floriye Tahiri, MMPHI

Dizajni: Përparim Gashi, AMMK/MMPHI

Prishtinë, 2025

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	6
1.1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT	6
1.2. STRUKTURA E RAPORTIT	7
2. METODOLOGJIA	7
3. RISHIKIMI I DOKUMENTEVE PÛRKATËSE POLITIKE DHE LIGJORE	8
4. GJETJET	10
4.1. GJETJET NGA GRUPET E FOKUSIT	10
4.2. VIZITAT E MONITORIMIT NË TERREN	12
4.3. ANKETA ME KONSUMATORË	14
4.3.1. <i>Frekuenca e blerjeve në dyqane të vogla (që nuk aplikojnë pagesën për qese)</i>	14
4.3.2. <i>Qëndrimet e publikut ndaj politikës së pagesës për qeset plastike</i>	15
4.3.3. <i>Pranueshmëria e politikës: Perceptimi i drejtësisë së tarifës prej 0.05 € për qeset plastike</i>	15
4.3.4. <i>Perceptimi publik për çmimin e qeseve plastike</i>	16
4.3.5. <i>Efektiviteti i Politikës për Tarifën e Qeseve Plastike</i>	17
4.3.6. <i>Opinione dhe Sugjerime të Respondentëve mbi Zbatimin e Tarifës për Qeset Plastike</i>	18
4.4. METODOLOGJIA DHE QASJA E VLERËSIMIT BAZUAR NË TË DHËNAT E SHITËSVE ME PAKICË	21
4.4.1. <i>Qasja e Vlerësimit</i>	21
4.4.2. <i>Supozimet e bazuara në strukturën e tregut</i>	21
4.4.3. <i>Procesi i Vlerësimit</i>	22
4.4.1. <i>Diskutim dhe Implikime</i>	23
5. VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT DHE NDIKIMIT TË POLITIKËS	25
5.1. NDIKIMI MJEDISOR	25
5.2. NDIKIMI SOCIAL	25
5.3. NDIKIMI EKONOMIK	26
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	27
6.1. KONKLUZIONE	27
6.2. REKOMANDIME	28
7. REFERENCAT	30

Tabelat

Table 1. Përmbledhje e gjetjeve nga grupet e fokusit.....	11
Tabela 2. Përmbledhje e gjetjeve nga vizitat monitoruese në terren mbi zbatimin e UA Nr. 07/2023 në sektorët e shitjes me pakicë	12
Table 3. Vlerësimi i qytetarëve për politikën e pagesës së qeseve plastike.....	15
Table 4. Opinione dhe Sugjerime të Respondentëve mbi Zbatimin e Tarifës për Qeset Plastike	18
Table 5. Vlerësimi i konsumit të qeseve të lehta plastike për bartje në Kosovë	23

Figurat

Figure 1. Sa shpesh keni bërë blerje në dyqane të vogla (si kioska, dyqane lagjesh) gjatë 30 ditëve të fundit? ...	14
Figure 2. Perceptimi i pranueshmërisë së tarifës prej 0.05 € për qeset plastike	16
Figure 3. A është e përshtatshme tarifa aktuale prej 0.05 € për qeset plastike? (n = 337)	16
Figure 4. Çmimi i preferuar i ardhshëm për qese plastike ndërmjet të anketuarve që e konsiderojnë €0.05 si të papërshtatshëm	17
Figure 5. Ndikimi i vetëraportuar i politikës së tarifës prej €0.05 për qeset plastike	17

Shkurtesa	Kuptimi i plotë në shqip
AMMK	Agjencia Për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
K4G	Programi <i>Kosovo4Green</i>
KBR	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (<i>nëse përmendet në anekse</i>)
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UA	Udhëzim Administrativ
n	Numri i të anketuarve

1. Hyrje

Qëllimi i vlerësimit është të analizojë progresin e bërë që nga hyrja në fuqi e UA Nr. 07/2023 (ndryshuar plotësuar nga UA Nr. 04/2025), duke u fokusuar në përputhshmërinë ndërmjet kategorive të ndryshme të shitësve me pakicë, koordinimin institucional, sjelljen e konsumatorëve dhe kontributin e politikës në reduktimin e gjenerimit të mbeturinave plastike.

Ky raport është për gatitur në përputhje me Termat e Referencës (ToR) dhe pasqyron diskutimet e mbajtura gjatë vitit 2024 ndërmjet GIZ-it, MMPHI-së dhe konsulencës. Raporti është hartuar edhe mbi bazën e një rishikim fillestar të dokumenteve përkatëse ligjore, politike dhe monitoruese, si dhe në konsultimet paraprake me palët kryesore institucionale dhe palët tjera të interesit. Raporti paraqet qëllimin dhe objektivat e vlerësimit, qasjen metodologjike, aktivitetet kryesore dhe rezultatet e pritura për përdorim të qeseve të plastikës. Raporti ofron një plan të strukturuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, duke kombinuar prova sasiore (regjistrat institucionale, anketat dhe të dhënat e shitësve me pakicë) me njohuri cilësore nga vizitat në terren, intervistat dhe diskutimet në grup fokusi. Kjo qasje siguron që vlerësimi do të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në evidencë për të informuar vendimmarrjen e ardhshme politike, për të forcuar mekanizmat e zbatimit dhe për të mbështetur përparimin e Kosovës drejt një ekonomie qarkore dhe standardeve mjedisore të përafëruara me BE-në.

1.1. Qëllimi dhe Objektivat e studimit

Qëllimi i përgjithshëm i këtij vlerësimi është të analizojë zbatimin, përputhshmërinë dhe ndikimet e hershme të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 07/2023 (ndryshuar plotësuar nga UA Nr. 04/2025), mbi reduktimin e përdorimit të qeseve plastike (25-50 mikron) në Kosovë.

Vlerësimi synon të:

- Vlerësojë shkallën e zbatimit të UA Nr. 07/2023 në të gjithë sektorin e shitjes me pakicë, duke u fokusuar në përputhshmërinë me dispozitat për tarifën e detyrueshme prej 0.05 €, etiketimin dhe standardet teknike.
- Vlerësojë përparimin drejt objektivit afatshkurtër të politikës për reduktimin e konsumit të qeseve plastike në 180 qese për person në vit deri në fund të vitit 2024.
- Ekzaminojë koordinimin institucional dhe mekanizmat e zbatimit, përfshirë shkëmbimin e të dhënave ndërmjet MMPHI-së, AMMK-së, Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Doganave dhe Inspektoratit të Tregut.
- Analizojë ndërgjegjësimin dhe ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve, duke u bazuar në të dhëna anketimi, vëzhgime në terren dhe diskutime në grupe fokusi.
- Identifikojë sfidat kryesore dhe boshllëqet e kapaciteteve që ndikojnë në efektivitetin e politikës, veçanërisht ndërmjet shitësve të vegjël dhe prodhuesve vendas.
- Zhvillojë rekomandime praktike dhe të bazuara në evidencë për MMPHI-në, AMMK-në dhe për të forcuar zbatimin e politikës, për të siguruar një zbatim të drejtë dhe për të mbështetur fazën kaluese drejt alternativave të qëndrueshme.
-

1.2. Struktura e raportit

Ky raport është i organizuar në disa seksione që së bashku paraqesin qasjen, gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit.

Seksioni 2 përshkruan qasjen metodologjike të studimit, duke detajuar zbatimin e një dizajni me metoda të kombinuara që integron rishikimin ligjor në bazë dokumentesh, mbledhjen e të dhënave institucionale, diskutimet në grupe fokusi, anketat me konsumatorë, vizitat monitoruese në terren, analizën e përputhshmërisë dhe trendëve, si dhe një vlerësim të shkurtër të ndikimit.

Seksioni 3 ofron një rishikim të dokumenteve përkatëse politike dhe ligjore, duke përmbledhur kornizën rregullatore dhe institucionale që qeveris reduktimin e qeseve plastike bartëse të lehta në Kosovë.

Seksioni 4 paraqet rezultatet e kërkimit në terren dhe diskutimet në grupe fokusi me palët kryesore të interesit, përmbledh gjetjet e anketës me konsumatorë, qasjen e vlerësimit të bazuar në të dhënat e shitësve me pakicë. Së fundmi, **Seksioni 5** paraqet përfundimet kryesore dhe rekomandimet politike, duke përshkruar veprime praktike për forcimin e zbatimit, rritjen e kuptueshmërisë publike dhe sigurimin e efektivitetit afatgjatë të politikës për reduktimin e qeseve plastike.

2. Metodologjia

Ky seksion përshkruan metodologjinë gjithëpërfshirëse që ka udhëhequr vlerësimin e politikës për tarifën prej 0.05 € për qeset plastike. Metodologjia është strukturuar rreth gjashtë komponentëve të ndërlidhur, secili i konceptuar për të adresuar një aspekt specifik të detyrës. Këta komponentë përfshijnë rishikimin ligjor dhe politik, mbledhjen e të dhënave institucionale, angazhimin në terren me palët e interesit, punën analitike, vlerësimin e ndikimit dhe formulimin e rekomandimeve. Për operacionalizimin e këtyre komponentëve, studimi mbështetet në katër linja kërkimore plotësuese:

- i. **Kërkimi dhe rishikimi i dokumenteve, raporteve dhe analiza dytësore** – rishikim sistematik i legjislacionit, dokumenteve politike dhe bazave ekzistuese të të dhënave.
- ii. **Kërkimi cilësor në terren** – Intervista gjysmë të strukturuar me grupe fokusi dhe palët e interesit për të kapur perceptimet, sfidat dhe praktikat më të mira.
- iii. **Të dhëna nga shitësit me pakicë mbi numrin e qeseve plastike** – të dhëna të siguruar nga shitësit me pakicë në Kosovë.
- iv. **Anketa me konsumatorë** – një anketë online e drejtuar qytetarëve për të analizuar sjelljen ndaj qeseve të plastikes njëpërdorimshme dhe për të nxjerrë normat mesatare të konsumit.

Të kombinuara, këto linja kërkimore ofrojnë një bazë të fortë të dhënash për vlerësimin e efektivitetit të politikës dhe për hartimin e rekomandimeve të zbatueshme. Seksioni vijues ofron një rishikim të dokumenteve dhe raporteve relevante lidhur me implementimin e UA Nr. 04/2025.

3. Rishikimi i dokumenteve përkatëse politike dhe ligjore

Korniza politike dhe ligjore e Kosovës për prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e qeseve plastike bartëse të lehta është zhvilluar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke u mbështetur në tri dokumente kryesore:

- Analizë mbi Qeset Plastike Bartëse (MMPHI, 2022),
- Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2023 për Paketimin dhe Mbeturinat e Paketimit (Qeveria e Kosovës, 2023), dhe
- Direktivën (BE) 2015/720 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (2015).

Këto dokumente së bashku përbëjnë bazën e politikës kombëtare për reduktimin e qeseve plastike dhe përafrimin e objektivave mjedisore të Kosovës me ato të BE-së.

Në vitin 2022, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), me mbështetjen e Qeverisë Gjermane dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), zhvilloi një analizë gjithëpërfshirëse të prodhimit, përdorimit dhe asgjësimit të qeseve plastike bartëse të lehta dhe shumë të lehta në Kosovë (MMPHI, 2022). Analiza tregoi se konsumi vjetor për frymë arrinte në 335 qese plastike, një ndër nivelet më të larta në rajon dhe në vendet e BE-së. Studimi identifikoi boshllëqet në legjislacion, ndikimet mjedisore dhe socio-ekonomike, dhe propozoi opsione të reja politike për zgjidhje efektive. Opsioni më i favorshëm ishte vendosja e një çmimi minimal të detyrueshëm për qeset e plastikes bartëse të lehta, i shoqëruar me fushata ndërgjegjësimi publik dhe stimuj për përdorimin e alternativave të ripërdorshme (MMPHI, 2022). Dokumenti parashikonte zbatimin në dy faza: fillimisht, vendosjen e një çmimi minimal prej 0.05 euro për qese, që përfshinte edhe një taksë mjedisore prej 0.02 euro të dedikuar për një fond të posaçëm; dhe më pas, ndalimin e plotë të qeseve plastike të lehta nëse objektivat e reduktimit nuk do të arriheshin deri në vitet 2025–2026. Ky dokument nënvizonte se reduktimi i konsumit të qeseve plastike është thelbësor për mbrojtjen e mjedisit dhe kalimin drejt modeleve të qëndrueshme të prodhimit e konsumit.

Në gusht të vitit 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2023 për Paketimin dhe Mbeturinat e Paketimit, duke e kthyer këtë politikë në një detyrim ligjor (Qeveria e Kosovës, 2023). Ky udhëzim përcaktoi objektiva të qarta kombëtare për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike: deri më 31 dhjetor 2024, konsumi nuk duhet të kalojë 180 qese për person në vit, ndërsa deri më 2030 duhet të ulet në 40 qese për person. Për zbatimin e këtyre objektivave, parashikohet raportimi i detyrueshëm vjetor nga prodhuesit, Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), për sasinë e qeseve të prodhuara, importuara dhe të shitura. Këto të dhëna do të mundësojnë krahasimin e rezultateve me vitin bazë 2022 dhe matjen e përparimit drejt objektivave të përcaktuara. Udhëzimi Administrative Nr.07/2023 shënon një hap të rëndësishëm në kalimin nga politika vullnetare në rregullim të detyrueshëm, duke përfshirë mekanizma çmimesh, standarde teknike dhe sisteme të monitorimit e raportimit. Komisioni Evropian, në Raportin e Progresit për Kosovën (Komisioni Evropian, 2024), e ka cilësuar këtë si një arritje të dukshme në përafrimin e politikave mjedisore të vendit me ato të BE-së.

Në nivel evropian, Direktivën (BE) 2015/720 për reduktimin e qeseve plastike bartëse të lehta e konsideron si një instrument ligjor themelor të BE-së për zbutjen e ndotjes nga plastika (Parlamenti Evropian & Këshilli i Bashkimit Evropian, 2015). Ajo ndryshon Direktivën 94/62/KE mbi paketimin

dhe mbeturinat e paketimit, duke vendosur masa konkrete për uljen e konsumit të qeseve plastike me trashësi nën 50 mikronë, të cilat janë më të dëmshme për mjedisin për shkak të përdorimit të kufizuar dhe potencialit të lartë për t'u hedhur. Direktiva kërkon që Shtetet Anëtare të miratojnë politika të matshme si çmime minimale, ndalesa në shpërndarje falas ose objektiva kombëtare të reduktimit, me synimin që përdorimi të mos kalojë 90 qese për person deri më 2019 dhe 40 qese deri më 2025 (Komisioni Evropian, 2020; Agjencia Evropiane e Mjedisit – AEM, 2021). Ajo thekson rëndësinë e fushatave të ndërgjegjësimit dhe standardizimit të raportimit për të garantuar transparencë, si dhe ofron fleksibilitet për vendosjen e instrumenteve ekonomike që reflektojnë koston mjedisore të plastikës, duke lejuar përjashtime për qeset shumë të lehta nën 15 mikronë që përdoren për arsye higjienike (CMS Law, 2024). Shembujt nga Irlanda dhe Portugalia, të cilat pas prezantimit të taksave plastike arritën reduktime mbi 90%, dëshmojnë efektivitetin e kësaj qasjeje (Convery et al., 2007; AEM, 2021).

Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2025i Kosovës është në përputhje të plotë me parimet e Direktivës, duke integruar objektiva të detyrueshme, masa ekonomike dhe mekanizma monitorimi. Kjo tregon përpjekjet e vazhdueshme të vendit për të harmonizuar legjislacionin mjedisor me acquis communautaire të BE-së dhe për të përmbushur angazhimet e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (Komisioni Evropian, 2023). Zbatimi i Direktivës 2015/720 ka sjellë rezultate të matshme në gjithë BE-në: sipas Eurostat (2024), çdo banor i BE-së përdori mesatarisht 66.6 qese plastike në vitin 2022, duke shënuar një rënie prej 14% krahasuar me vitin 2021. Kjo rënie reflekton përhapijen e gjerë të masave të bazuara në çmime dhe fushata ndërgjegjësimi që kanë ndryshuar sjelljen e konsumatorëve dhe kanë reduktuar ndjeshëm ndotjen plastike. Megjithatë, mbeten dallime midis vendeve, pasi disa shtete si Belgjika dhe Portugalia janë afër arritjes së objektivit të 2025-ës, ndërsa vende të tjera si Lituania dhe Letonia vazhdojnë të kenë konsum të lartë për shkak të përdorimit të qeseve shumë të lehta.

Në tërësi, kjo kornizë politike dhe ligjore përfaqëson një hap të rëndësishëm për Kosovën në drejtim të përafrimit me standardet evropiane, duke institucionalizuar politika të bazuara në evidencë, ndryshim sjelljeje dhe qëndrueshmëri afatgjatë. Dokumenti Politik i vitit 2022 vendosi bazën analitike dhe rekomandoi masa ekonomike për ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ 07/2023 e ktheu këtë vizion në instrument ligjor të zbatueshëm. Përafrimi i këtyre dokumenteve me Direktivën (BE) 2015/720 përbën dëshmi të përkushtimit të Kosovës ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe kalimit drejt një ekonomie qarkulluese. Kjo qasje e integruar e vendos Kosovën në rrugën e duhur drejt reduktimit të ndotjes plastike, përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave dhe zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

4. Gjetjet

4.1. Gjetjet nga grupet e fokusit

Diskutimet e zhvilluara me grupet e fokusit — përfaqësues institucionalë, prodhues, shitës me pakicë dhe inspektorë të tregut ofruan një pasqyrë të gjerë mbi sfidat, përparimet dhe hapat e ardhshëm në zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2023 dhe atij të ri aprovuar UA Nr. 04/2025 për qeset plastike bartëse të lehta.

Rezultatet tregojnë se, edhe pse korniza ligjore është vendosur dhe ka sjellë përmirësime të dukshme në uljen e përdorimit të qeseve plastike, mbeten sfida të rëndësishme në fushat e raportimit të të dhënave, koordinimit ndërinstitutional, mbikëqyrjes së tregut dhe mbështetjes ekonomike për prodhuesit lokalë.

Një tjetër problem i theksuar ishte mungesa e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse. Secili institucion apo agjenci operon me sistemin e vet të raportimit. Përfaqësuesit theksuan se ky fragmentim pengon monitorimin e qëndrueshëm dhe vlerësimin real të progresit të politikës.

Në tregun e brendshëm, u konstatua një hendek i dukshëm midis shitësve të mëdhenj dhe atyre të vegjël. Zinxhirët e mëdhenj të supermarketeve e zbatojnë rregullin e çmimit prej 0.05 € dhe raportojnë saktë shitjet, ndërsa tregjet dhe dyqanet e vogla shpesh ofrojnë qese falas dhe të kundërligjshëm, pa faturim apo raportim, duke krijuar konkurrencë të padrejtë dhe humbje të të ardhurave tatimore.

Në të njëjtën kohë, informaliteti vazhdon të jetë një pengesë për mbledhjen e të dhënave të sakta. Qarkullimi i qeseve plastike të paregjistruara, sidomos në tregjet lokale, përbën një pjesë të konsiderueshme të aktivitetit të padukshëm ekonomik.

Një gjetje tjetër e rëndësishme lidhet me ndikimin ekonomik të çmimit minimal prej 0.05 €. Megjithatë kjo masë ka reduktuar dukshëm konsumin e qeseve plastike, ajo ka shkaktuar rënie të fortë të prodhimit vendor. Prodhuesit paralajmëruan se, pa mbështetje financiare dhe teknike, disa fabrika rrezikojnë mbylljen. Për këtë arsye, u propozua që një pjesë e të ardhurave të gjeneruara nga tarifa të rishpërndahen përmes granteve, kredive të buta dhe kuponëve të inovacionit, për të ndihmuar tranzicionin drejt produkteve të biodegradueshme dhe të ripërdorshme.

Nga ana tjetër, inspektorët e tregut raportuan se zbatimi në terren është ende i pjesshëm dhe kryesisht formal. Kontrollonhet kryesisht etiketimi dhe prania e logos, ndërsa mungojnë pajisjet për matjen e trashësisë së qeseve (25–50 mikronë). Për më tepër, deri më sot nuk janë shqiptuar gjopa për shkelje të rregullores, si fillim për shkak të fazës tranzitore të zbatimit dhe pas kalimit të kësaj faze.

Grupi i inspektorëve theksoi nevojën për rritje të kapaciteteve teknike dhe për krijimin e një “dashboard”-i të përbashkët dixhital për regjistrimin e inspektimeve, analizën e trendëve dhe ndarjen e të dhënave ndërmjet agjencive.

Në përfundim, grupet e fokusit u pajtuan se Kosova ka bërë përparim të dukshëm në formalizmin e tregut dhe uljen e përdorimit të qeseve plastike, por për të arritur objektivat deri në 2030 kërkohet bashkëpunim më i ngushtë ndërinstitutional, përmirësim i sistemit të raportimit, mbështetje për prodhuesit vendorë dhe komunikim më efektiv me publikun. Në Tabela 1 janë të përmbledhur në mënyrë sintetike të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e dala nga këto diskutime të kombinuara.

Table 1. Permbledhje e gjetjeve nga grupet e fokusit

Kategoria	Gjetjet Kryesore	Citime Ilustruese	Rekomandime
Saktësia e të dhënave dhe çështjet e matjes	Si ATK ashtu edhe Doganat e Kosovës raportuan kapacitete të kufizuara për të ndjekur saktësisht prodhimin, importin dhe shitjen e qeseve plastike të lehta. Aktualisht, ATK nuk ka mekanizma për të kërkuar apo regjistruar të dhëna mbi sasinë e qeseve plastike të shitura ose të shpërndara, ndërsa Doganat nuk mund të dallojnë midis kategorive të ndryshme të produkteve plastike nën kodet ekzistuese tarifore.	“Qeset plastike regjistrohen vetëm sipas kilogramëve, jo sipas copave individuale, dhe nuk kategorizohen si qese plastike njëpërdorimshme nga Doganat gjatë importit. Në ATK nuk mund t’u kërkojmë kompanive të raportojnë produkte të veçanta — ato raportojnë vetëm shitjet totale. Nuk mund ta dimë sa qese qarkullojnë realisht.”	Të prezantohet raportimi sipas njësive (copave) dhe të krijohen kode specifike doganore për qeset plastike të lehta (25–50 mikronë). Të krijohet një sistem i unifikuar të dhënash ndërinstucional (ATK, Dogana dhe Inspektorati i Tregut) për monitorim të saktë dhe të qëndrueshëm.
Koordinimi ndërmjet palëve të interesit	Ka koordinim dhe shkëmbim të kufizuar informacioni ndërmjet institucioneve kyçe përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e Udhëzimit Administrativ — përfshirë ATK-në, Doganat, AMMK-në dhe Inspektoratin e Tregut.	“Të gjithë punojmë për të njëjtën çështje, por na duhen forma specifike për plotësimin e të dhënave. Po ashtu nuk ka pasur bashkëpunim adekuat në implementimin e përgjegjësisë.”	Të krijohet një platformë qendrore dixhitale për raportim dhe të përcaktohen qartë rolet dhe procedurat për ndarjen e të dhënave ndërmjet institucioneve.
Shitësit e mëdhenj kundrejt atyre të vegjël	Zinxhirët e mëdhenj të marketeve respektojnë rregullin e 0.05 €, duke kontribuar me rreth 60% të përdorimit kombëtar, ndërsa tregjet dhe furrat e vogla shpesh nuk lëshojnë fatura apo nuk raportojnë shitjet e qeseve plastike.	“Tregjet e mëdha e respektojnë rregullin, por dyqanet e vogla i japin qeset falas dhe nuk i raportojnë — aty qëndron problemi kryesor.”	Të forcohet inspektimi i shitësve të vegjël, të zbatohen fushata ndërgjegjësimi dhe të sigurohet zbatim i drejtë i ligjit për të gjithë aktorët e tregut.
Informaliteti dhe boshllëqet në zbatim	Informaliteti vazhdon kryesisht në dyqanet e vegjël dhe furrat që shpërndajnë qese të paregjistruara, duke dëmtuar mbledhjen e të ardhurave dhe analizën e saktë.	“Shumë dyqane të vogla nuk i lëshojnë fatura dhe nuk raportojnë qeset plastike — janë të padukshme për sistemin.”	Të intensifikohen inspektimet në terren dhe të promovohet zbatimi i përbashkët ndërmjet ATK-së, Doganave dhe Inspektoratit.
Ndikimi ekonomik i tarifës 0.05-€	Prezantimi i çmimit minimal prej 0.05 € sipas UA 07/2023 ka çuar në një reduktim të ndjeshëm të konsumit të qeseve plastike, por gjithashtu ka shkaktuar një rënie të fortë në prodhimin vendor.	“Prodhimi ra tek prodhuesit e qeseve plastike. Kjo politikë po ka dëmtuar fabrikat vendore dhe se kompanitë po përpiqen të gjejnë produkte inovative për të kompensuar këtë efekt.”	Të realizohet një vlerësim gjithëpërfshirës i ndikimit ekonomik dhe të krijohen programe tranzicioni për prodhuesit e prekur përmes granteve, kredive dhe mbështetjes teknike.
Përputhshmëria dhe zbatimi	Zinxhirët e mëdhenj zbatojnë rregullat, por dyqanet e vogla shpesh nuk aplikojnë tarifën prej 0.05 €; nuk janë shqiptuar gjoba.	“Ne ndjekim ligjin dhe i tarifojmë të gjitha qeset, por të tjerët jo — kjo është e padrejtë.”	Të aplikohen sanksione për mos raportim dhe të përqendrohen inspektimet tek tregtarët e vegjël.
Koordinimi me institucionet	Bizneset raportojnë koordinim të dobët me ATK-në, Doganat dhe AMMK-në. Kodet doganore i grupojnë të gjitha produktet plastike bashkë.	“Dogana i fut të gjitha nën një kod — nuk mund të ndjekim importet.”	Të përcaktohen qartë protokollet e raportimit dhe të organizohen takime të rregullta me industrinë.
Operatorët informalë dhe të paligjshëm	Shitësit e paregjistruar shpërndajnë qese nën trashësinë standarde dhe pa logo ose tatim.	“Disa njerëz shesin qese nga garazhet — nuk paguajnë taksa dhe nuk ndjekin asnjë rregull.”	Të zhvillohen operacione të përbashkëta ATK–Dogana–Inspektorat për identifikimin e prodhuesve të paligjshëm dhe

			të zbatohet një sistem gjurmueshmërie që lidh qeset me prodhuesit e licencuar.
Mbështetje financiare dhe teknike	Prodhuesit paralajmërojnë rrezik mbylljeje pa ndihmë nga qeveria. Aktualisht nuk ka programe publike që mbështesin modernizimin e industrisë.	“Na duhet mbështetje nga qeveria për të zhvilluar produkte të tjera.”	Të ofrohen grante dhe linja kredie për të ndihmuar kompanitë të diversifikohen në produkte të biodegradueshme dhe të ripërdorshme.
Ndërgjegjësimi dhe sjellja e konsumatorëve	Konsumatorët blejnë më pak qese për shkak të çmimit, por shpesh mungon ndërgjegjësimi për qëllimin mjedisor të politikës.	“Tarifa prej 0.05 € i bën klientët të mendojnë dy herë — por shumë nuk e dinë pse kjo ka rëndësi.”	Të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi publik dhe materiale edukative në pikat e shitjes.

4.2. Vizitat e monitorimit në terren

Për qëllime të vëzhgimit të drejtpërdrejtë në terren, përfaqësuesit nga GIZ dhe AMMK, zhvilluan vizita monitoruese në disa komuna për të vlerësuar zbatimin dhe zbatueshmërinë e Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 07/2023 për qeset plastike bartëse të lehta.

Tabela 2. Përmbledhje e gjetjeve nga vizitat monitoruese në terren mbi zbatimin e UA Nr. 07/2023 në sektorët e shitjes me pakicë

Sektori i shitjes / lokacioni	Shembujt e vizituar	A aplikohet tarifa prej 0.05 €	Logo / etiketë e dukshme	Alternativa të disponueshme	Vëzhgime kryesore	Vlerësim i përgjithshëm
Markete të mëdha dhe të mesme	5 zingjirë marktesh	Po (në mënyrë të qëndrueshme)	Po, në qeset e arkës	Të kufizuara; kryesisht plastike	Arkëtarët pyetnin rregullisht klientët sa qese dëshironin; tarifa shfaqej në arkë. Në dy zinxhirë, në seksionet e pemëve dhe perimeve u përdorën qese me dorezë dhe shumë të holla (<25 mikronë) – të dyja jo në përputhje.	Përputhshmëri e lartë në përgjithësi, por mospërputhje të pjesshme në seksionet e frutave/perimeve.
Tregje të vogla / dyqane lokale	Dyqane lokale në Prishtinë, Fushë Kosovë, Drenas, Kaçanik	Jo (qeset falas)	Jo	Jo	Shitësit shpesh të painformuar për rregulloren; qeset shpërndahen falas pa çmim apo etiketim.	Nuk aplikohet Përputhshmëri
Furra dhe lokale ushqimore të vogla	Furra dhe 2 lokale ushqimore	Jo (qeset falas)	Jo	Asnjë e vërejtur	Qeset jepen automatikisht; konsumatorët nuk informohen për kërkesat e politikës.	Nuk aplikohet përputhshmëri
Prodhues / shumicë shitës	Kompani prodhuese e qeseve te plastikes (Prishtinë)	I regjistruar; i vetëdijshëm për standardet	Po, në produktet e furnizuara	Po (opsione biodegraduese)	Raportuan rënie të ndjeshme të kërkesës që nga futja e tarifës; reduktim në prodhim dhe eksplorim të linjave të reja produktesh.	Në përputhje, por ekonomikisht të prekur

Në sektorin formal të shitjes me pakicë (marketet e mëdha dhe të mesme), tarifa prej 0.05 € aplikohet rregullisht dhe regjistrohet qartë në arkë, duke treguar se politika po zbatohet siç synohet, sidomos aty ku procedurat janë të standardizuara dhe mbikëqyrja është më e fortë. Në kontrast, tregjet e vogla dhe furrat shpesh nuk e aplikojnë tarifën dhe mungojnë logot apo kodet e shiritit, duke çuar në zbatim të pabarabartë dhe dobësim të sinjalit mjedisor të politikës. U vunë re edhe shkelje teknike në seksionet e frutave dhe perimeve të dy marketeve të mëdha, ku përdoren qese me dorezë dhe nën 25 mikronë — të ndaluara sipas UA Nr. 07/2023.

Në anën e ofertës, prodhuesit raportuan rënie të shitjeve pas vendosjes së tarifës, duke sinjalizuar një zhvendosje pozitive drejt reduktimit të konsumit, por njëkohësisht edhe nevojën për mbështetje të industrisë vendore gjatë tranzicionit. Rezultatet e monitorimit tregojnë se politika e Kosovës për reduktimin e qeseve plastike po ndikon me sukses në sjelljen e konsumatorëve dhe praktikën e shitjes në mesin e aktorëve të mëdhenj dhe formalë, por mbetet më pak efektive tek tregtarët e vegjël dhe informalë.

4.3. Anketa me konsumatorë

Për të plotësuar vlerësimin institucional dhe në terren mbi tarifën prej 0.05€ për qeset plastike, u realizua një anketë me 341 konsumatorë nga komuna të ndryshme.

Qëllimi: të matet njohuria, qëndrimet dhe ndryshimi i sjelljes pas hyrjes në fuqi të tarifës. Anketa u shpërnda online (kampion vetë-përzgjedhur), prandaj gjetjet reflektojnë më fort publikun digjitalisht aktiv, por ofrojnë gjithsesi njohuri të vlefshme për pranueshmërinë dhe efektin e politikës. Shpërndarja gjinore është relativisht e balancuar, (56% gra, 44% burra). Pothuaj gjysma (45%) janë blerësit kryesorë të ushqimeve në familje dhe 29% e ndajnë rolin, çka i bën të ndjeshëm ndaj masave në pikën e shitjes.

4.3.1. Frekuenca e blerjeve në dyqane të vogla (që nuk aplikojnë pagesën për qese)

Kuptimi i mënyrës dhe shpeshtësisë së blerjeve ditore të qytetarëve ofron njohuri të vlefshme mbi sjelljen e konsumatorëve, burimet e mundshme të moszbatimit të politikës për pagesën e qeseve plastike dhe shkallën e aktivitetit informal në tregtinë me pakicë në Kosovë. Pyetja mbi shpeshtësinë e blerjeve në dyqanet e lagjeve (si kioska, furra buke dhe mini-markete) ndihmon në identifikimin e rasteve kur konsumatorët nder veprojnë me pika shitjeje që kanë më shumë gjasa të shpërndajnë qese falas dhe të veprojnë jashtë mekanizmave formalë të monitorimit.




Figure 1. Sa shpesh keni bërë blerje në dyqane të vogla (si kioska, dyqane lagjesh) gjatë 30 ditëve të fundit?

Gjetjet tregojnë se tregtarët e vegjël dhe informal mbeten si kryesoret në përditshmërinë e konsumit (Figura 1). Rreth 43% e të anketuarve blejnë në dyqane të vogla disa herë në javë dhe 19% çdo ditë, duke treguar varësi të lartë nga këto pika shitjeje. Kjo paraqet sfidë për zbatimin e UA Nr. 07/2023, pasi shumë mikro-biznese veprojnë jashtë sistemit formal dhe shpërndajnë qese plastike falas, duke dobësuar efektin e tarifës dhe duke reflektuar përmasat e ekonomisë informale. Prandaj, forcimi i mbikëqyrjes, fushatat e ndërgjegjësimit dhe stimulimi i alternativave të biodegradueshme janë thelbësore për zbatim të barabartë dhe rezultate të matshme mjedisore.

4.3.2. Qëndrimet e publikut ndaj politikës së pagesës për qeset plastike

Për të vlerësuar perceptimet dhe reagimet e qytetarëve ndaj masës së re të prezantuar nga Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2023, të anketuarve iu drejtuan disa pyetje lidhur me qëndrimet, pranimin dhe ndryshimet e sjelljes pas vendosjes së tarifës prej 0.05 € për qeset plastike.

Table 3. Vlerësimi i qytetarëve për politikën e pagesës së qeseve plastike

Deklarata	Po	Neutrale	Jo
Unë e mbështes politikën për pagesën e qeseve plastike	65.5%	11.6%	22.9%
Kur paraqitet nevoja,, unë me dëshirë paguaj për një qese plastike	9.7%	13.9%	76.4%
Politika e pagesës ka ndikuar që të përdor më pak qese plastike	63.0%	15.1%	22.0%
E sjell më shpesh qesen time që nga futja e pagesës	24.9%	29.1%	46.0%
E sjell qesen time kryesisht për arsye mjedisore, jo vetëm për të shmangur pagesën	43.5%	12.9%	43.5%
E sjell qesen time për të mbështetur mbrojtjen e mjedisit (motivim i përgjithshëm mjedisor)	56.7%	15.2%	28.2%

Rezultatet e anketës tregojnë se politika e pagesës për qeset plastike gëzon mbështetje të gjerë publike dhe ka ndikuar dukshëm në sjelljen e konsumatorëve. 65.5% e mbështesin politikën, por vetëm 9.7% i blejnë qeset me dëshirë, çka tregon ndjeshmëri ndaj çmimit. Rreth 63% thonë se përdorin më pak qese, ndërsa 46% i sjellin më shpesh qeset e tyre të ri përdorshme. Për më tepër, 56.7% e bëjnë këtë për arsye mjedisore, duke reflektuar rritje të ndërgjegjësimit. Ne thelb, tarifa ka funksionuar si nxitës ekonomik që po shoqërohet gradualisht me motivim mjedisor, duke përforcuar sjelljet e qëndrueshme. Megjithatë, monitorimi i tregtarëve dhe fushatat e ndërgjegjësimit publik mbeten thelbësore për të ruajtur e zgjeruar këtë ndikim pozitiv.

4.3.3. Pranueshmëria e politikës: Perceptimi i drejtësisë së tarifës prej 0.05 € për qeset plastike

Kuptimi i mënyrës se si qytetarët e perceptojnë drejtësinë dhe pranueshmërinë e tarifës prej 0.05 € është thelbësor për vlerësimin e legjitimitetit shoqëror dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të politikës. Pranimi nga publiku përcakton nëse masa shihet si një instrument i arsyeshëm mjedisor apo si një barrë shtesë ekonomike për konsumatorët.




Figure 2. Perceptimi i pranueshmërisë së tarifës prej 0.05 € për qeset plastike

Tarifa për qeset plastike është gjerësisht e pranuar, me 56.5% të qytetarëve që e vlerësojnë si të drejtë dhe të pranueshme (figura 2). Vetëm <20% e kundërshtojnë, ndërsa 25% mbeten neutralë. Kjo tregon një legjitimitet të fortë shoqëror, të lidhur me ndërgjegjësimin mjedisor dhe përvojat nga politika të ngjashme në rajon. Qytetarët e perceptojnë tarifën si të drejtë dhe proporcionale, duke krijuar bazë për pajtueshmëri të qëndrueshme dhe masa të reja mjedisore. Në fakt, 57.1% e të anketuarve tashmë mbështesin ndalimin e plotë të qeseve plastike, duke treguar gatishmëri për hapa më të fortë drejt mbrojtjes së mjedisit.

4.3.4. Perceptimi publik për çmimin e qeseve plastike

Perceptimi i çmimit luan rol kyç në efektivitetin e tarifës prej 0.05 €, duke përcaktuar nëse ajo dekurajon realisht përdorimin e qeseve plastike apo shihet si masë simbolike. Për këtë arsye, anketa përfshiu pyetje mbi përshtatshmërinë e tarifës aktuale dhe çmimin e mundshëm të ardhshëm. Rreth 33% e të anketuarve e konsiderojnë çmimin aktual të drejtë, ndërsa 40.1% mendojnë se është i pamjaftueshëm dhe 27.3% mbeten të pasigurt (figura 3). Kjo tregon një pritshmëri për masa më të forta dhe nevojë për më shumë komunikim mbi qëllimin mjedisor të politikës.




Figure 3. A është e përshtatshme tarifa aktuale prej 0.05 € për qeset plastike? (n = 337)

Ndër ata që e konsiderojnë tarifën të ulët, 37% sugjerojnë 0.10 €, 35% mbi 0.25 €, dhe 19% preferojnë 0.20 € (Figura 4). Kjo tregon gatishmëri të gjerë për rritje çmimi, duke u parë si mjet efektiv për uljen e përdorimit të plastikës. Në përgjithësi, rezultatet sugjerojnë se publiku është i hapur ndaj rritjes progresive të tarifës, duke e perceptuar si të drejtë dhe në përputhje me praktikën më të mira të BE-së për reduktimin e plastikës njëpërdorimshme.




Figure 4. Çmimi i preferuar i ardhshëm për qese plastike ndërmjet të anketuarve që e konsiderojnë €0.05 si të papërshtatshëm

4.3.5. Efektiviteti i Politikës për Tarifën e Qeseve Plastike

Për të vlerësuar efektivitetin e politikës së tarifës prej 0.05 € për qeset plastike, të anketuarve iu kërkuar të shprehnin nëse kjo masë kishte ndikuar në sjelljen e tyre gjatë blerjeve. Rezultatet, të paraqitura në Figurën 5, tregojnë një reagim të fortë të sjelljes ndaj politikës.




Figure 5. Ndikimi i vetëraportuar i politikës së tarifës prej €0.05 për qeset plastike

Rezultatet e paraqitura në Figurën 8 vlerësojnë efektivitetin e tarifës prej €0.05 në ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve. Gjetjet janë shumë inkurajuese: 76.9% e të anketuarve raportuan se tani përpiqen në mënyrë aktive të përdorin më pak qese plastike, duke dëshmuar një reagim të qartë të sjelljes ndaj politikës. Vetëm 16% deklaruan se nuk kanë ndryshuar zakonet e tyre të blerjes, ndërsa një grup i vogël (7%) mbeti i pasigurt nëse politika kishte ndikuar tek ata.

Këto rezultate ofrojnë dëshmi të forta se mekanizmi i çmimit ka qenë efektiv në promovimin e praktikave më të qëndrueshme tek konsumatorët. Fakti që më shumë se tre të katërtat e të anketuarve pranojnë një reduktim në përdorimin e qeseve plastike tregon se masa ka arritur të shkaktojë një ndryshim të rëndësishëm të sjelljes brenda një periudhe relativisht të shkurtër zbatimi.

Nga një këndvështrim politikash, këto gjetje konfirmojnë se nxitjet ekonomike mund të nxisin me sukses ndryshime mjedisore kur zbatohen në mënyrë të qëndrueshme dhe shoqërohen me komunikim të fortë publik. Reagimi i gjerë i sjelljes gjithashtu mbështet argumentin për ruajtjen ose edhe rritjen e tarifës në fazat e ardhshme për të konsoliduar përparimin e arritur.

Për më tepër, pjesa e vogël por e qëndrueshme e të anketuarve që nuk kanë ndryshuar zakonet e tyre nënvizon nevojën për fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi publik dhe monitorim të synuar të tregtarëve që ende mund të ofrojnë qese falas. Trajtimi i këtyre boshllëqeve do të jetë thelbësor për të siguruar që potenciali i plotë mjedisor i politikës të realizohet dhe të ruhet në kohë.

4.3.6. Opinione dhe Sugjerime të Respondentëve mbi Zbatimin e Tarifës për Qeset Plastike

Përveç rezultateve kuantitative të anketës, u analizua edhe një grup pyetjesh të hapura për të kapur perspektivat cilësore dhe subjektive të të anketuarve mbi zbatimin e tarifës për qeset plastike. Këto përgjigje narrative ofrojnë njohuri të vlefshme mbi qëndrimet e publikut, sfidat e perceptuara dhe sugjerimet për përmirësimin e politikës, duke dhënë një kuptim më të thellë të përvojave qytetare përtej treguesve statistikore (Tabela 4). Nga 241 përgjigjet e mbledhura, shumica e pjesëmarrësve dhanë opinione pozitive dhe sugjerime konkrete për përmirësimin e zbatimit të tarifës për qeset plastike dhe reduktimin e përdorimit të tyre. Rreth 40% e përgjigjeve ishin neutrale ose “Jo” (pa sugjerim specifik), ndërsa rreth 60% përmbanin rekomandime të vlefshme, të cilat mund të grupohen në disa kategori tematike.

Table 4. Opinione dhe Sugjerime të Respondentëve mbi Zbatimin e Tarifës për Qeset Plastike

Kategoria e Opinionit/Sugjerimit	Përshkrimi	Përqindja e përafërt e përgjigjeve
Heqja e plotë ose ndalimi i qeseve plastike	Pjesëmarrësit theksuan se qeset plastike duhet të ndalohen plotësisht dhe të zëvendësohen me alternativa të qëndrueshme.	~25%
Zëvendësimi me qese letre, tekstili ose biodegradueshme	Një pjesë e madhe kërkoi promovimin e qeseve prej letre, kartoni apo pëlhere si opsione miqësore me mjedisin.	~20%
Rritja e çmimit të qeseve plastike	Disa të anketuar sugjeruan se çmimi aktual prej €0.05 është shumë i ulët për të ndikuar në sjelljen e konsumatorëve dhe duhet të rritet në €0.10–€0.20.	~10%
Ndërgjegjësim publik dhe edukim mjedisor	U propozua zhvillimi i fushatave sensibilizuese, veçanërisht në shkolla dhe media, për të ulur përdorimin e plastikës.	~8%

Mbështetje për politika më të rrepta dhe zbatim të fortë	Komentet kërkonin sanksione ndaj shitësve që nuk respektojnë rregulloren dhe stimuj për ata që përdorin alternativa ekologjike.	~7%
Kritika ndaj politikës aktuale	Një grup më i vogël e vlerësoi tarifën €0.05 si joefektive, të pjesshme ose të padrejtë.	~5%
Sugjerime praktike të tjera	Përfshinin ide si dhënia falas e qeses së parë, promovimi i qeseve të ripërdorshme ose përdorimi i materialeve të riciklueshme.	~5%
Pa koment ose neutrale ("Jo", "Pa sugjerim")	Të anketuarit nuk dhanë opinione shtesë.	~40%

Rezultatet tregojnë një nivel të lartë ndërgjegjësimi publik për rëndësinë e kufizimit të përdorimit të qeseve plastike; megjithatë, shumica e të anketuarve theksojnë se masat aktuale janë të pamjaftueshme për të arritur ndryshim të qëndrueshëm të sjelljes.

Tendencat kryesore që dalin nga analiza janë si vijon:

Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve kërkoi ndalimin e plotë të qeseve plastike, duke e konsideruar këtë si mënyrën më efektive për të mbrojtur mjedisin. Sipas tyre, pagesa simbolike prej €0.05 nuk ka qenë e mjaftueshme për të ndryshuar sjelljen as të konsumatorëve, as të tregtarëve. Ata sugjeruan që institucionet të ecin drejt një ndalese ligjore dhe zëvendësimit të qeseve me materiale alternative.

Shumë të tjerë propozuan promovimin e përdorimit të qeseve prej letre, tekstili ose materialeve biodegraduese, të cilat ruajnë funksionalitetin por kanë ndikim shumë më të ulët në mjedis. Kjo kategori theksoi nevojën për mbështetje të prodhuesve vendorë për zhvillimin e këtyre produkteve përmes politikave stimuluese dhe subvencioneve që lehtësojnë tranzicionin drejt alternativave më të gjelbra.

Një grup tjetër qytetarësh u shpreh se çmimi aktual prej 0.05€ është shumë i ulët dhe nuk dekurajon përdorimin e qeseve plastike. Sipas tyre, vetëm një rritje e ndjeshme e çmimit, në nivelin €0.10–€0.20, mund të ketë efekt edukativ dhe të ndikojë në sjelljen e konsumatorëve. Disa sugjeruan gjithashtu që qesja e parë të jetë falas, ndërsa të tjerat me pagesë, për të balancuar ndërgjegjësimin mjedisor me përballueshmërinë ekonomike.

Një gamë e gjerë komentesh theksoi rëndësinë e edukimit dhe ndërgjegjësimin publik mbi ndikimin e plastikës në mjedis. Pjesëmarrësit nënvizuan se politika e tarifimit nuk duhet të mbetet vetëm një masë fiskale, por duhet të shoqërohet me programe ndërgjegjësimi në shkolla, media dhe komunitete lokale, për të ndërtuar një kulturë të re të konsumit të përgjegjshëm.

Disa të anketuar kërkuar monitorim dhe zbatim më të rreptë, pasi disa tregtarë ende ofrojnë qese plastike falas ose jashtë standardeve të përcaktuara. Kjo nënvizon nevojën për forcim të inspektimeve dhe gjobave administrative, për të siguruar zbatim të barabartë të rregullores për të gjithë operatorët ekonomikë.

Një pjesë më e vogël e qytetarëve e vlerësoi politikën aktuale si të pjesshme, joefektive ose me ndikim minimal mjedisor, duke argumentuar se masa ka përfituar më shumë tregtarët sesa mjedisi. Ata kërkuar rishikim të transparencës dhe drejtësisë sociale të politikës.

Në përfundim, gjetjet tregojnë se qytetarët mbështesin parimin e reduktimit të përdorimit të qeseve plastike, por kërkojnë përmirësime në disa fusha kyçe si forcim të zbatimit dhe inspektimeve,

rritje graduale të çmimit për të ndikuar sjelljen e konsumatorëve, mbështetje për prodhuesit e alternativave ekologjike, dhe edukim të vazhdueshëm publik për ndikimin e plastikës në mjedis.

Diskutimi i përgjigjeve tregon se shoqëria kosovare është gjithnjë e më e gatshme të përqafojë ndryshime pozitive mjedisore, por pret që këto masa të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të shoqërohen me veprime praktike. Për MMPHI dhe AMMK-n, këto njohuri përbëjnë një burim të vlefshëm informacioni për rishikimin e politikave ekzistuese dhe zhvillimin e nismave të reja që promovojnë materiale të qëndrueshme, forcojnë zbatimin dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive të qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit.

4.4. Metodologjia dhe Qasja e Vlerësimit bazuar në të dhënat e shitësve me pakicë

4.4.1. Qasja e Vlerësimit

Vlerësimi kuantitativ është ndërtuar mbi të dhëna reale të siguruar nga Zyra e Inspektoratit të Përgjithshëm, të bazuara në inspektime dhe raporte të verifikuara të dorëzuara në AMMK. Këto të dhëna përfaqësojnë regjistrime zyrtare të mbledhura nga Inspektorati i Tregut i Kosovës nga 12 prej kompanive më të mëdha tregtare që operojnë në nivel kombëtar, të cilat së bashku vlerësohet se përbëjnë rreth 80% të tregut total formal të shitjes me pakicë.

Shifrat e raportuara janë verifikuar përmes inspektimeve në terren të kryera nga inspektorët e tregut, për të siguruar besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e setit të dhënave. Numri total i qeseve të lehta plastike për bartje të raportuara nga këto kompani arrin në 49,995,838 njësi gjatë vitit referues 2024. Duke e ndarë këtë shifër me popullsinë totale të Kosovës prej 1,585,590 banorësh, rezulton një mesatare prej afërsisht 32 qese plastike për person në vit.

4.4.2. Supozimet e bazuara në strukturën e tregut

Për të prodhuar një vlerësim kombëtar gjithëpërfshirës, janë bërë rregullime për të marrë parasysh mbulimin e tregut dhe aktivitetin e sektorit informal. Këto supozime janë zhvilluar duke u bazuar në njohuritë e marra nga diskutimet në grupet fokale dhe intervistat me prodhues, tregtarë dhe inspektorë, si dhe në referenca nga raportet mbi ekonominë informale të Kosovës.

Rregullimi për tregun formal (20%)

- Pasi që të dhënat fillestare përfaqësojnë afërsisht 80% të tregut formal të shitjes me pakicë, ato u zgjeruan me 20% për të vlerësuar konsumin total të tregut formal. Kjo rritje prej 20% është nxjerrë nga diskutimet në grupet fokale me tregtarë, për të siguruar një pasqyrim më të saktë të strukturës së përgjithshme të tregut.¹
- Ky rregullim përfshin dyqanet e vogla formale dhe kompani të tjera që operojnë brenda ekonomisë formale, e që nuk janë përfshirë ndër 12 tregtarët më të mëdhenj të mbuluar në setin fillestar të të dhënave.
- Pas përfshirjes së këtij segmenti shtesë të tregut formal, numri total i vlerësuar i qeseve të lehta plastike të shitura ose të shpërndara rritet në 62,494,797.5 njësi, që korrespondon me rreth 40 qese për person në vit.

¹ Vlen të theksohet se autori, me mbështetjen e GiZ dhe AMMK, zhvilloi tre grupe fokusi tematike — me prodhues, shitës me pakicë dhe inspektorë — si dhe një sërë intervistash gjysmë të strukturuar me palët institucionale. Gjatë këtyre diskutimeve, pjesëmarrësit dhanë vlerësime për rreth 20% të tregut formal që nuk mbulohej nga të dhënat e 12 zinxhirëve më të mëdhenj të marketeve në Kosovë, si dhe informata mbi shkallën e aktivitetit ekonomik informal që lidhet me shpërndarjen e qeseve plastike. Këto konsultime, së bashku me referencat ndaj raporteve ekzistuese mbi ekonominë informale në Kosovë, shërbyen si bazë për supozimet e përdorura në procesin e ekstrapolimit.

Rregullimi për tregun informal (40%)²

- Bazuar në kontributet e palëve të interesit, studimet ekonomike të disponueshme dhe monitorimet në terren të kryera nga autoret e raportit së bashku me ekipin e GLZ, sektori i tregtisë informale — që përfshin dyqanet e vogla, furrat e bukës, kioskat dhe tregjet lokale — u vlerësua se përbën edhe 40% shtesë të qarkullimit total të qeseve plastike.
- Shumë prej këtyre bizneseve vazhdojnë të shpërndajnë qese plastike falas, jashtë mekanizmave zyrtarë të raportimit.
- Pas aplikimit të këtij rregullimi, konsumi total kombëtar i vlerësuar i qeseve të lehta plastike arrin në 87,492,716.5 njësi, që korrespondon me afërsisht 55 qese për person në vit.

4.4.3. Procesi i Vlerësimit

Tabela 5 paraqet procesin hap pas hapi të vlerësimit që është përdorur për të llogaritur numrin total të qeseve të lehta plastike të përdorura çdo vit në Kosovë dhe mesataret për frymë përkatëse. Të dhënat e siguruara nga Zyra e Inspektoratit të Përgjithshëm përmes inspektimeve të kryera në 12 kompanitë më të mëdha tregtare, mbulon afërsisht 80% të tregut formal dhe raporton një total prej 49,995,838 qese, që përfaqëson rreth 32 qese për person.

Për të përfaqësuar tregun e plotë formal, u aplikua një rregullim prej 20%, duke e rritur vlerësimin në 62,494,797.5 qese, ose afërsisht 40 qese për person.

Në fund, për të marrë parasysh sektorin informal të tregtisë, i cili përfshin dyqanet e vogla, furrat e bukës dhe tregjet lokale që zakonisht shpërndajnë qese plastike falas, u shtua edhe një rregullim shtesë prej 40%.

Kjo e çon konsumin total të vlerësuar kombëtar në 87,492,716.5 qese, që i korrespondon afërsisht 55 qeseve për person në vit.

Kështu, tabela ofron një kornizë progresive të vlerësimit, duke filluar nga të dhënat e verifikuara përmes inspektimeve dhe duke përfshirë supozime të mbështetura në diskutimet me grupet fokale, kontributet e palëve të interesuara dhe vëzhgimet në terren, për të siguruar që vlerësimi përfundimtar të pasqyrojë si dinamikat e tregut formal ashtu edhe ato të tregut informal.

² Sipas Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), ekonomia në hije në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 39.5%, bazuar në Indeksin e Ekonomisë në Hijë. (shih Mustafa, I., Shiroka-Pula, J., Krasniqi, B., Sauka, A., Berisha, G., Pula, L., Lajqi, S., & Jaha, A. (2019). Analiza e ekonomisë në hije në Kosovë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.). Po ashtu, sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ekonomia informale në Kosovë përlllogaritet të jetë rreth 30–35% e PBB-së. Raportet e FMN-së theksojnë se ky nivel i lartë informaliteti është veçanërisht i pranishëm në sektorët e tregtisë, bujqësisë, ndërtimit dhe shërbimeve, duke ndikuar drejtpërdrejt në konkurrencën e ndershme, të hyrat fiskale dhe produktivitetin ekonomik (shih IMF (2022). Kosovo: Staff Report for the Article IV Consultation. International Monetary Fund). Sipas Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), ekonomia informale në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 33%, duke e renditur vendin ndër ekonomitë me nivelin më të lartë të informalitetit në rajon (RCC, 2021). Ekonomia informale në Kosovë variron ndërmjet 30% dhe 40% të PBB-së, duke e renditur vendin ndër ekonomitë më të informalizuara në Ballkan.

Table 5. Vlerësimi i konsumit të qeseve të lehta plastike për bartje në Kosovë

Kategoria	Llogaritja	Numri total i qeseve të konsumuara (të shitura ose të dhëna falas)	Mesatarja për frymë (popullsia = 1,585,590)	Shpjegimi
Numri total i qeseve plastike (raportuar nga 12 kompani)	Seti bazë i të dhënave	49,995,838.00	≈ 31.5 → rrumbullaksuar në 32	Përfaqëson 80% të tregut formal.
Vlerësimi për 100% të tregut formal	49,995,838 (duke shtuar edhe 20% te tregut formal)	62,494,797.5	≈ 39.4 → rrumbullksuar në 40	Shtohet 20% për të mbuluar pjesën e patrajtuar të tregut formal.
Vlerësimi kombëtar total (duke shtuar 35% treg informal)	62,494,797.5 + (duke shtuar 35% te tregut jo formal)	84,367,977	≈ 53 qese/banor	Shtohet 35% për sektorin informal (dyqane të vogla, furra, etj.).
Vlerësimi kombëtar total (duke shtuar 40% treg informal)	62,494,797.5 + (duke shtuar 40 % te tregut jo formal)	87,492,716.5	≈ 55.2 qese/banor	Shtohet 40% për sektorin informal (dyqane të vogla, furra, etj.).

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhëna të siguruar nga Inspektorati i Tregut i Kosovës dhe në supozimet e nxjerra nga diskutimet në grupet fokusit dhe vëzhgimet në terren.

4.4.1. Diskutim dhe Implikime

Rezultatet e këtij vlerësimi tregojnë se konsumi mesatar vjetor i qeseve të lehta plastike për bartje në Kosovë është rreth 55 qese për person, kur merren parasysh aktivitetet si të tregut formal ashtu edhe atij informal. Edhe pse kjo shifër mbetet nën mesataren e BE-së prej 66.6 qese për person (Eurostat, 2022), ajo gjithsesi pasqyron një nivel të konsiderueshëm përdorimi të qeseve plastike, që vazhdon të paraqesë sfida për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave.

Shifra relativisht më e ulët krahasuar me mesataren e BE-së mund të pasqyrojë efektin e hershëm të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 07/2023 (ndryshuar plotësuar nga UA Nr. 04/2025), i cili solli masa rregullatore për prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e qeseve plastike, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit në mesin e tregtarëve të mëdhenj.

Zinxhirët kryesorë të marketeve kanë filluar tashmë të zbatojnë mekanizma çmimesh, standarde teknike dhe detyrime raportimi, të cilat duket se kanë reduktuar përdorimin e qeseve plastike në sektorin formal të tregtisë me pakicë.

Megjithatë, analiza zbulon se një pjesë e konsiderueshme e qarkullimit të qeseve plastike ndodh brenda ekonomisë informale, që përbën rreth 40% të konsumit total. Ky sektor — që përfshin dyqanet e vogla, furrat e bukës, kioskat dhe tregjet lokale — shpesh i shpërndan qeset plastike falas dhe mbetet kryesisht jashtë mekanizmave aktualë të monitorimit dhe zbatimit. Si rrjedhojë, praktikat informale vazhdojnë të dobësojnë efektivitetin e politikës dhe të shtrembërojnë të dhënat zyrtare mbi konsumin.

Për të forcuar ndikimin e kuadrit rregullator të Kosovës dhe për t'u përafruar më shumë me objektivat mjedisore të BE-së, dalin disa implikime kryesore politike:

- Forcimi i monitorimit dhe zbatimit të ligjit: Zgjerimi i fushës së inspektimeve për të përfshirë edhe tregtarët e vegjël dhe ata informale do të siguronte mbikëqyrje më të plotë të shpërndarjes dhe zbatimit të tarifës për qeset plastike.
- Ndërgjegjësim publik dhe ndryshim sjelljeje: Fushata që theksojnë ndikimin mjedisor të plastikës njëpërdorimshme dhe promovojnë alternativa të ripërdorshme mund të reduktojnë më tej kërkesën, sidomos në mesin e bizneseve të vogla dhe konsumatorëve.
- Përmirësimi i sistemeve të të dhënave: Zhvillimi i një mekanizmi të integruar raportimi përmes Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AMMK) do të mundësonte standardizimin e mbledhjes së të dhënave dhe reduktimin e varësisë nga raportimi manual.
- Nxitje për tranzicionin e gjelbër: Sigurimi i mbështetjes fiskale dhe teknike për tregtarët e vegjël që të kalojnë në ambalazhe të biodegradueshme ose të ripërdorshme do të përshpejtonte adoptimin në nivel të tregut.
- Vlerësim i vazhdueshëm: Kryerja e vlerësimeve periodike të konsumit të qeseve plastike duhet të institucionalizohet, për t'i mundësuar politikëbërësve matjen e efektivitetit të UA 07/2023 dhe rregullimin e instrumenteve politike sipas nevojës

5. Vlerësimi i Efektivitetit dhe Ndikimit të Politikës

5.1. Ndikimi Mjedisor

Vlerësimi tregon se Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 07/2023 ka gjeneruar efekte të dukshme të hershme mjedisore, kryesisht përmes uljes së përdorimit të qeseve plastike në sektorin formal të tregtisë. Të dhënat e shitësve me pakicë tregojnë një ulje të ndjeshme të qeseve të shpërndara, ndërsa llogaritjet e kombinuara formale dhe informale vlerësojnë se konsumi mesatar vjetor aktual është rreth 55 qese për person, më i ulët se mesatarja e BE-së (66.6) .

Marketet e mëdha zbatojnë rregullin në mënyrë konsistente: tarifa shfaqet në arkë, qeset tarifohen dhe etiketohen sipas kërkesave, dhe konsumatorët pyeten rregullisht për sasinë e qeseve të nevojshme.

Anketimi i konsumatorëve mbështet këto gjetje: 76.9% deklarojnë se tani përpiqen të përdorin më pak qese, ndërsa 63% thonë se tarifa ka ndikuar drejtpërdrejt në sjelljen e tyre .

Megjithatë, sfida të rëndësishme mbeten në tregtinë e vogël dhe sektorin informal, ku qeset shpërndahen shpesh falas, pa etiketa dhe jashtë sistemit formal të raportimit. Kjo dobëson ndikimin mjedisor të politikës dhe ngadalëson progresin drejt objektivit kombëtar prej 40 qese për person deri në 2030.

Në përmbledhje, masa ka gjeneruar reduktim të dukshëm të konsumit në sektorin formal, ndryshim sjelljeje te konsumatorët, dhe ka vendosur një sinjal të qartë të hershëm mjedisor, por kërkon forcim të zbatimit tek operatorët e vegjël për të maksimizuar efektin e saj.

5.2. Ndikimi Social

UA Nr. 07/2023 ka sjellë ndryshime të rëndësishme në sjelljen e konsumatorëve, duke krijuar norma të reja për përdorimin e qeseve të ri përdorshme dhe uljen e mbeturinave plastike. Gati 2/3 e qytetarëve e mbështesin politikën dhe rreth 57% shprehen se do të mbështesnin madje edhe ndalimin e plotë të qeseve plastike. Kjo tregon rritje të pranimi shoqëror dhe gatishmëri për masa më të avancuara. Motivimi mjedisor po rritet sepse bazuar në ankete rreth 56.7% e qytetarëve deklarojnë se sjellin qesen e tyre për “arsye mjedisore”, jo vetëm për të shmangur pagesën. Tarifa prej 0.05 € ka funksionuar si nxitës i sjelljes, por ndërgjegjësimi i publikut mbetet i pabarabartë.

Gjetjet gjithashtu tregojnë një nivel të lartë varësie nga dyqanet e vogla, ku mungesa e zbatimit krijon perceptime të pabarazisë dhe ulë besimin te masa. Shumë qytetarë theksojnë nevojën për informim më të mirë, sidomos tek tregtarët e vegjël dhe komunitetet që marrin qese falas nga dyqanet e vogla të lagjës.

Përfitimi social kryesor i politikës deri tani është normalizimi i sjelljes së ripërdorshme dhe reduktimi i përdorimit të qeseve plastike, i cili, me mbështetje të mëtejshme edukative, mund të kthehet në praktikë të përhershme.

5.3. Ndikimi Ekonomik

Ndikimi ekonomik i UA Nr. 07/2023 është i dyfishtë:

(a) Për konsumatorët dhe bizneset

Tarifa prej 0.05 € ka krijuar sinjal të fortë çmimi që ka ulur kërkesën për qese plastike. Në sektorin formal, përdorimi është ulur në mënyrë të konsiderueshme. Megjithatë, gatishmëria për të paguar është e ulët: vetëm 9.7% i blejnë qeset me dëshirë, ndërsa pjesa më e madhe i shmangin ato nëpërmjet qeseve të ripërdorshme. Kjo nxit konsumin e përgjegjshëm, por krijon presion mbi sektorin informal që vazhdon të shpërndajë qese falas.

(b) Për prodhuesit vendorë

Ky është segmenti më i prekur ekonomikisht. Prodhuesit raportojnë rënien e prodhimit për shkak të reduktimit të kërkesës në tregun formal dhe konkurrencës së qeseve informale të pakontrolluara. Disa kompani nënvizuan rrezikun e mbylljes së linjave të prodhimit në mungesë të mbështetjes teknike dhe financiare. Ky ndryshim është pozitiv nga perspektiva mjedisore, por krijon sfida tranzicioni për industrinë vendore. Politika ka reduktuar konsumin, por pa masa mbështetëse, rrezikon të dëmtojë prodhuesit vendas dhe të shtyjë tregun drejt zëvendësimit me produkte të importuara.

6. Konkluzione dhe Rekomandime

6.1. Konkluzione

Gjetjet e këtij vlerësimi tregojnë se politika për reduktimin e qeseve plastike në Kosovë (UA Nr. 07/2023) ka gjeneruar tashmë ndryshime të dukshme në sjelljen e konsumatorëve dhe në treg, brenda një periudhe relativisht të shkurtër zbatimi. Vendosja e tarifës prej 0.05 € për çdo qese plastike të lehtë ka ndikuar ndjeshëm në ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve dhe ka krijuar një normë të re mjedisore në rrjetet formale të tregtisë me pakicë.

Përputhshmëria e lartë në mesin e tregtarëve të mëdhenj dhe të mesëm, përfshirë rrjetet e marketeve, dëshmon se rregullorja është e zbatueshme dhe efektive kur ekzistojnë sisteme të qarta monitorimi, faturimi dhe etiketimi. Në këto pika shitjeje, konsumatorët pyeten rregullisht se sa qese dëshirojnë të blejnë, dhe kostoja paraqitet qartë në arkë, duke treguar një ndryshim kulturor të qëndrueshëm drejt konsumit të vetëdijshëm.

Megjithatë, moszbatimi mbetet i përhapur në mesin e tregtarëve të vegjël dhe atyre informalë, veçanërisht në furrat e bukës, dyqanet e lagjeve dhe tregjet e hapura, ku qeset plastike shpërndahen ende falas, pa etiketa dhe pa regjistrim. Kjo krijon pabarazi në zbatim, dobëson efektin pengues të politikës dhe mban në qarkullim një pjesë të konsiderueshme të qeseve plastike që shmangin monitorimin formal.

Vazhdimi i këtyre praktikave reflekton si mungesën e ndërgjegjësimit të bizneset e vogla, ashtu edhe mungesat në kapacitetet inspektuese në nivel komunal dhe kombëtar. Për më tepër, mosrespektimi teknik mbetet i pranishëm edhe në mesin e tregtarëve që formalisht përmbushin detyrimet.

Disa markete vazhdojnë të përdorin qese shumë të holla (<25 mikronë) me doreza, të cilat ndalohen me UA Nr. 07/2023. Mungesa e udhëzimeve të qarta teknike dhe klasifikimit të produkteve ka shkaktuar konfuzion si tek menaxherët e dyqaneve, ashtu edhe tek furnizuesit.

Nga perspektiva e prodhimit, prodhuesit e qeseve plastike raportojnë rënie të shitjeve dhe prodhimit pas vendosjes së tarifës.

Edhe pse ky rezultat tregon përparim në reduktimin e konsumit, ai gjithashtu nxjerr në pah sfidat ekonomike të përshtatjes për prodhuesit vendorë, të cilët tani duhet të adaptohen ndaj dinamikave të reja të tregut.

Mbështetja e këtyre kompanive në kalimin drejt produkteve të biodegradueshme dhe të ripërdorshme do të jetë thelbësore për të ruajtur ekuilibrin midis objektivave mjedisore dhe qëndrueshmërisë ekonomike.

Rezultatet e anketës së konsumatorëve përforcojnë këto gjetje nga terreni.

Rreth 77% e të anketuarve raportojnë se tani përpiqen të përdorin më pak qese plastike, ndërsa 65% shprehin qëndrim pozitiv ndaj politikës.

Megjithatë, rreth 40% e konsiderojnë tarifën aktuale shumë të ulët, duke sugjeruar se sinjali ekonomik ekzistues mund të mos jetë i mjaftueshëm për të nxitur ulje të mëtejshme të përdorimit.

Anketa gjithashtu tregon nivel të kufizuar të kuptimit të qëllimit mjedisor të politikës te disa grupe demografike, duke theksuar nevojën për fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi publik.

Në tërësi, të dhënat tregojnë se UA Nr. 07/2023 ka arritur me sukses të ndryshojë sjelljen e konsumatorëve në rrjetet formale të shitjes, por problemet sistematike si fragmentimi i të dhënave, moszbatimi i barabartë dhe koordinimi i pamjaftueshëm institucional vazhdojnë të kufizojnë efektivitetin e plotë të saj.

Adresimi i këtyre sfidave do të jetë thelbësor për të arritur objektivin e Kosovës për reduktimin e mëtejshëm të konsumit të qeseve plastike për person në vit dhe për përputhjen e praktikave kombëtare me standardet mjedisore të BE-së dhe agjendën e ekonomisë qarkore.

6.2. Rekomandime

Duke u mbështetur në gjetjet e këtij vlerësimi, paraqiten disa rekomandime të synuara për të forcuar efektivitetin, zbatimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2023. Këto veprime synojnë të sigurojnë që rregullorja të sjellë ndikim të qëndrueshëm mjedisor, zbatim të drejtë në të gjitha segmentet e tregtarëve, si dhe koordinim më të mirë ndërinstitutional. Këto veprime do të:

1. Forcojnë kapacitetet e inspektimit dhe zbatimit.

- Të krijohet një program i strukturuar inspektimesh që synon tregtarët e vegjël dhe furrat e bukës.
- Të krijohet një sistem i shkallëzuar zbatimi, që kombinon vizitat informuese, paralajmërimet formale dhe gjobat.
- Të zhvillohen fushata të përbashkëta inspektimi me pjesëmarrjen e AMMK-së, Inspektoratit të Tregut dhe autoriteteve komunale.

2. Sqarojnë dhe harmonizojnë standardet teknike.

- Të njoftohet një udhëzim teknik që përcakton llojet e lejuara të qeseve, trashësinë minimale të materialit dhe standardet e etiketimit.
- Të përfshihen shembuj vizualë dhe lista kontrolli të përputhshmërisë për të ndihmuar si inspektorët ashtu edhe tregtarët.

3. Përmirësojnë mbledhjen e të dhënave dhe koordinimin ndërinstitutional.

- Të zhvillohet një platformë digjitale e përbashkët raportimi, që lidh Doganat, ATK-në, KEPA-n dhe inspektoratet.
- Të kërkohet raportim tremujor nga tregtarët e mëdhenj dhe prodhuesit e regjistruar për shitjet, importet dhe llojet e materialeve.
- Të realizohet një anketë vjetore me kampion përfaqësues të konsumatorëve për të matur ndikimin e ndryshimeve të politikës.

4. Mbështesin tranzicionin dhe inovacionin vendor.

- MMPH-ja duhet të lancojë programe që ofrojnë grante të vogla ose asistencë teknike për prodhuesit e qeseve të plastikës që investojnë në produkte të biodegradueshme ose të ripërdorshme

- b. Të iniciohen partneritete publiko-private për zhvillimin e linjave të prodhimit vendas me materiale miqësore ndaj mjedisit.

5. Rrisin ndërgjegjësimin dhe edukimin e konsumatorëve.

- a. Të zbatohen fushata kombëtare informimi që shpjegojnë qëllimin dhe ndikimin e tarifës prej 0.05 €.
- b. Të nisen programe me komunitetet dhe shkollave që promovojnë përdorimin e qeseve të ripërdorshme dhe konsum të qëndrueshëm.
- c. Të bashkëpunohet me marketet për të vendosur kujtesa në pikat e shitjes dhe stimuj të vegjël për konsumatorët që sjellin qeset e tyre.

Për të siguruar përputhshmëri të plotë dhe progres të qëndrueshëm, veprimet e ardhshme duhet të përqendrohen në zgjerimin e inspektimeve tek bizneset e vogla, forcimin e mekanizmave të zbatimit, qartësimin e standardeve teknike dhe mbështetjen e prodhuesve vendas përmes asistencës financiare dhe teknike gjatë tranzicionit drejt alternativave të qëndrueshme.

Në tërësi, këto masa do të sigurojnë që politika e reduktimit të qeseve plastike në Kosovë të zbatohet në mënyrë të drejtë, të mbështetur në të dhëna të sakta dhe të qëndrueshme, përmes zbatimit institucional dhe angazhimit publik. Gjithashtu do të forcojnë përparimin e vendit drejt standardeve mjedisore të përafruara me BE-në dhe një ekonomie më qarkore dhe efikase në përdorimin e burimeve.

7. Referencat

- ASHAK (2019), *Analiza e ekonomisë në hije në Kosovë*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- CMS Law. (2024). *Plastics and packaging laws in the European Union*. (Retrieved from <https://cms.law/en/int/expert-guides/plastics-and-packaging-laws/european-union>
- Convery, F., McDonnell, S., & Ferreira, S. (2007). *The most popular tax in Europe? Lessons from the Irish plastic bags levy*. *Environmental and Resource Economics*, 38(1), 1–11. <https://doi.org/10.1007/s10640-006-9059-2> .
- European Commission. (2020). *Reducing plastic bag use in Europe*. Brussels: Directorate-General for Environment.
- European Commission. (2023). *Green Agenda for the Western Balkans: Implementation Progress Report*. Brussels: European Commission.
- European Commission. (2024). *Kosovo 2024 Report: Accompanying the Communication on EU Enlargement Policy*. SWD(2024) 333 final. Brussels: European Commission. (https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf)
- European Environment Agency (EEA). (2021). *Plastics, the circular economy and Europe's environment: A priority for action* (EEA Report No. 18/2021). Copenhagen: EEA.
- European Parliament, & Council of the European Union. (2015). *Directive (EU) 2015/720 of the European Parliament and of the Council of 29 April 2015 amending Directive 94/62/EC as regards reducing the consumption*
- Eurostat. (2024, November 12). *4.7 billion fewer lightweight plastic bags in 2022*. European Commission, Directorate-General for Eurostat. Retrieved from <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/w/ddn-20241112-2>.
- Government of Kosovo. (2023). *Administrative Instruction (GRK) No. 07/2023 on Packaging and Packaging Waste*. Prishtina: Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure.
- International Monetary Fund. (2022). *Kosovo: Staff report for the Article IV consultation*. IMF.
- KEPA. (2023). *Annual environmental report 2023: Waste management and plastic use trends in Kosovo*. Prishtina, Kosovo: Kosovo Environmental Protection Agency.
- Kosovo Agency of Statistics (KAS). (2024). *Population estimates and household structure, 2024*. Prishtina, Kosovo: KAS.
- of lightweight plastic carrier bags*. *Official Journal of the European Union*, L 115/11–15.
- Regional Cooperation Council. (2021). *Balkan Barometer 2021*. RCC.
- United Nations Environment Programme (UNEP). (2021). *Single-use plastic bags and their alternatives: Recommendations for policy makers*. Nairobi, Kenya: UNEP.
- World Bank. (2022). *Regional report on circular economy practices in the Western Balkans*. Washington, DC: World Bank.